



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Prot 1165/4

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRANUAR DOREZUAR: DATUM/PRILIM DOSTAVLJEN:		22. 11. 2016	
DATE RECEIVED SUBMITTED:			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
10	11	933	2



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI DHE PLANI I VEPRIMIT PËR AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA MES INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Mbi bazën e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur me 14 shkurt 2012, midis dy Institucioneve Supreme të Auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit (në marrëveshje Zyra e Auditorit të Përgjithshëm), e Republikës së Kosovës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, i Republikës së Shqipërisë, hartojnë planin e veprimit për aktivitete të përbashkëta për periudhën kohore 2017/2018.


1. Me qëllim të angazhimit për thellimin e bashkëpunimit, ky plan synon realizimin e aktiviteteve si më poshtë:
 - shkëmbimin e përvojave në nivel praktik dhe teknik për zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të auditimit publik dhe praktikave të mira evropiane;
 - vijimin e traditës së krijuar midis dy institucioneve për realizimin e seminareve, workshop-eve dhe trajnimeve të përbashkëta, të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve të audituesve të KLSH dhe ZKA.
 - shkëmbimi i informacioneve dhe materialeve relevante për të shmangur punën e dyfishtë;
 - Sesione edukative – këshilluese me qëllim përditësimin e materialeve të metodologjisë në auditim, për fushat me interes të përbashkët; dhe
 - 6 auditime të përbashkëta në dy vitet në vijim (qëllimi i auditimit dhe çështjet kyçe do të vendosen bashkërisht dhe raportet e auditimit do t'u dërgohen Parlamenteve respektive). Temat e përzgjedhura për t'u audituar do të kenë interes kombëtar dhe rajonal dhe do t'i shërbejnë zhvillimit të strategjive kombëtare të të dy vendeve.

2. Drejtuesit e të dy institucioneve do të caktojnë Koordinatorët e Programit, të cilët do të mbikëqyrin zhvillimin dhe implementimin e këtij programi dhe do të raportojnë tek Kryetari i KLSH-së dhe Auditori i Përgjithshëm i Kosovës në mënyrë të vazhdueshme.
3. Informacionet, progresi dhe rezultatet e aktiviteteve të përbashkëta do të analizohen në baza vjetore në një takim të përbashkët në mes të krerëve të të dy institucioneve.
4. Këtij Programi do t'i bashkëngjitet, plani i detajuar vjetor për implementimin e aktiviteteve që përfshinë personat përgjegjës dhe numrin e pjesëmarrësve.
5. Pas aprovimit të Programit nga krerët e të dyja institucioneve, Koordinatorët e Programit do të zhvillojnë planin vjetor të aktiviteteve dhe do të kujdesen për përditësimin e tij, sipas nevojës.


Ky Program hyn në fuqi në momentin e aprovimit dhe nënshkrimit nga krerët e të dyja institucioneve.

Nënshkruar në Prishtinë, më 22/11/2016.

Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit
të Republikës së Shqipërisë



Bujar Leskaj



Auditori i Përgjithshëm i
Republikës së Kosovës



Besnik Osmani

